REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.3998 Prot

Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr. 75, datë 25.06.2026

"Për miratimin e proces verbalit të datës 29.05.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 8, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 88, i Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë proces verbalin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 29.05.2026 bashkangjitur.

2.Kopja e proceverbalit të miratuar administrohet nga Sekretari i Këshillit sipas procedurave ligjore.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 29.05.2026 Prot.55 (pesëdhejtëepesë)

Protokoll nr. 55

I mbajtur sot më datë 29.05.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (30.04.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin prill 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V"Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.S.K banues në Fshatin Vloçisht Nj.A Libonik, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
7.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 "*Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";* i ndryshuar.
8.P-V "Miratimin e shpërblimit me honorar për anagazhimin e një koreografi për ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Mulltifunksionale "*Dhimitër Orgocka"*, Maliq";
9.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.146, datë 24.12.2025, "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2026";*
10.P-V "Për miratimin e Raportit të I-rë të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026";
11.P-V "Për miratimin e programit të transparencës të Bashkisë Maliq";
12.P-V "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve nga programi i subvencionit të qirasë";
13.P-V"Për miratimin në parim për dhënien në përdroim të fondit pyjor, për ndërtimin e Kullave Eolike nga Kompania *"WP MORAVA"* shpk.";
14.P-V "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.19 datë 30.01.2026, "*Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi t ë Bashkisë Maliq";*
15.Prezantimi i Raportit të Performancës për Bashkinë Maliq viti 2025.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

16.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Aramando Dautllari; Dritan Çami; Floreta Zaçe; Marinathi Avrami; Idlir Limllari; Xhuana Hoxhallari; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Andonaq Risto; Dalina Krekas; Neresida Shindo; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Server Xhuti; 18(tetëmbëdhgjetë) këshilltarë.

Mungesa: Rovena Terolli; Klea Baçi; Almir Elezi; Eriseld Jonusllari; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; Eglantina Balli; Server Xhuti; Marjeta Xhelollari; 13 (trembëdhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e të Ardhurave në bashki;znj.Jona Grabocka; Drejtore e Shërbimit Social;znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli; Përgjegjës i Emergjencave Civile; z.Stiljan Belishta; Përgjegjës i Sektorit të Pyje/Kullota;z.Klarsen Brako.

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve. Të nderuar kolegë , të nderuar pjesëmarrës, po fillojmë me mbledhjen e këshillit, mbledhjen e radhës të këshillit bashkiak, sikurse jeni njoftuar.Në radhë të parë bëjmë një verifikim të korumit. Në sallë janë 16, 17këshilltarë dhe korumi realizohet dhe mund të vijojmë me mbledhjen. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës me të cilin jeni njohur, është bërë dhe publik. Kush është dakord? 17 vota pro.

Kundër? Nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet rendi i ditës prej 16 pikash, po të marrim edhe diskutime të tjera. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar të cilat janë në gjithsej 10, 5 vendime me karakter normativ dhe 5 të tjera me karakter kolektiv. Por të paktën këto me karakter normativ të cilat kanë shkuar në institucionin e prefektit dhe kanë marrë dakordësinë e prefektit Qarkut. Dhe ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar. Kush është dakord me protokollin e mbledhjes? 17 vota pro.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim nuk ka, miratohet protokolli i mbledhjes së kaluar. Tani, hajde kryetar mirë se erdhe. Sipas rendit të ditës kalojmë tek pika 4 e rendit që është projektvendim për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin prill 2026. Ju lutem komisioni i përkatës për ndihmën ekonomike.

Faslli Zholi:Përshëndetje kolegë këshilltarë, përshëndetje kryetar i këshillit, përshëndetje kryetar i bashkisë, përshëndetje pjesëmarrës në këtë takim, në mbledhjen e këshillit të bashkisë. Ne si komision bëmë takimin me telefon që nga salla sepse ashtu ishin mundësitë dje. Për sa i përket ndihmave ekonomike, i pamë ato listat, duhet të sqarojmë një diçka të cilën edhe me ekzekutivin

kemi biseduar. Në kontrollin e këtyre ndihmave janë bërë dhe disa ndryshime ose disa heqje nga skema sepse sipas kritereve të janë bërë dhe verifikimet dhe mundësia e disa familjeve të cilët sipas rastit edhe nuk janë paraqitur siç e ka dhe ligji. Menduam që si anëtarë të komisionit për ndihmat ekonomike listat që pamë paraprakisht unë ju ftoj të gjithëve për ta miratuar. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.Kemi një gjë tek pika 4? E kalojmë votim. Kush është dakord me pikën 4? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet pika 4, faleminderit. Dhe sipas rendit të ditës kalojmë tek pika 5 që është projektvendim për dhënie ndihmë financiare për familjet në nevojë. Dhe janë 5 familje këtu në projektvendim. Ermanda ne kemi 5, të lutem na sqaro kush është edhe një tjetër? Kemi zonjën L.K, E.D, D.M, V.M dhe S.H.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti:Është shtuar edhe njëherë, në materialet ne e kemi dërguar faktikisht, por ndoshta gabimisht nuk ishte shpërndarë materiali i këshillit. Ka edhe një rast tjetër, A.M nga njësi administrative, Pojan, e cila është një familje në vështirësi ekonomike dhe duheshte mbështetur sipas menaxhimit të rastit të mbrojtjes së fëmijëve.

Mirë, faleminderit. Kemi ndonjë gjë tjetër?

Faslli Zholi: Ne i pamë edhe këtë që thotë vajza për të shtuar, ramë dakord që ta fusnim sot se dokumentat nuk e di si e kështu. Jemi dakord t'i shikojmë, por unë kam gjithmonë e kam ngritur këtë shqetësim se i pashë ato familjet jo më sëmundur e kështu. Duhet të jemi shumë më të kujdesshëm me këto se shumë familje ka kështu dhe unë nuk jam për ata që do presim ndihmën e njerëzve të marrin ndihmë, por edhe duhet të parë një çikë me anën shëndetësore, me dokumentat, me gjërat të jeni sa më të kujdesshëm. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Kryetar kishe gjë te kjo? Mirë, kemi një gjë tjetër? Çfarë ka? E kalojmë në votim atëherë pikën 5?
Kush është dakord duke shtuar këtë zonjën në fund. Kemi 5 emra, është dhe kjo zonja A.M. 17 vota pro.
Kundër ka? Abstenim? Nuk ka, me 17 vota pro miratohet. Kalojmë tek pika 6 e rendit të ditës që është projektvendim për dhënie ndihmë financiare të menjëhershme për familje të nevojë. Dhe është fjala për një familje e cila i është djegur banesa, në mos gaboj, komisioni kemi ndonjë gjë tjetër? E kalojmë votim atëherë?
Kush është dakord me pikën 6? 17 vota pro
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet pika 6, faleminderit. Kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës që është projektvendim për disa ndryshime në vendimin e këshillit të bashkisë Maliq me numër 2, datë 08. 01. 2026. Rishqyrtimi i vendimit të këshillit të bashkisë Maliq nr. 147, datë 24. 12. 2025 për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë i ndryshuar. Komisioni i financës?

Petrit Kupe: Po, bëhet fjalë për një projektvendim që ka të bëjë me ndryshim, për mendimin tim jo në strukturë, por në ndryshim në nivelin e pagave. Sepse nuk ka shtesë të numrit të punonjësve, por vetëm për një kategori që është menduar nga ana e bashkisë që të ndryshojë paga në funksion të kryerjes së detyrave të tyre. Bëhet fjalë për në sektorin e kulturës, në sektorin e shërbimeve, nëse marrim me radhë dhe jemi ok që këto paga të ndryshohen, të rriten ashtu siç është propozuar. Këto kishim.

Ornildi Demollari: Zoti kryetar, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një problematikë në totalin e përgjithshëm të strukturave të bashkisë, duke qenë që në vendimmarrjen që kemi marrë në miratimin e buxhetit ne kemi ulur një numër të orëve të punës për punonjësit, pothuaj në përgjithësi, edhe të ngarkesës që ka në punë, por edhe të performancës që ata japin herë pas here. Ne po ta shikoni, s'kemi sjellë herë pas here disa ndryshime duke parë performancën apo ngarkesën që ka çdo punonjës në territor, edhe sipas propozimeve që na vijnë nga drejtuesit që kemi në sektor. Pasi në momentin kur kemi miratuar buxhetin në fund të vitit të kaluar, ne kemi bërë një propozim këshilli dhe është bërë një miratim sipas atij momenti që flasim, sipas njohjes, performancës, ngarkesës. Dhe ndaj në disa raste ne ju kemi sjellë edhe ndryshime të këtij lloji, nuk ndryshon numri i punonjësve, por ndryshon përmirësimi me një orë apo me një shtesë brenda limitit dhe atyre të pagave. E njëjta gjë ndodh edhe për disa punonjës, kemi dy punonjës të tatimtaksave, një në Libonikë edhe një në Moglicë, që janë me shkollë të mesme, të cilët nuk i kini në material, të cilët doja t'i propozoja për t'i përmirësuar me 5000 lekë orën e punës. Edhe një inxhinier mekanik, i cili duam t'i shtojmë 5000 lekë ta përmirësojmë për efekt të asaj çfarë unë citova pak më lart. Në qoftë se gjejmë mirëkuptim në këshill, bashkë me këto dy ndryshime të bëjmë komplet miratimin e këtij projektvendimi.

Ornildi Demollari: Po?

Andonaq Risto: Se ne diskutuam dhe në komiison e ekonomisë, në komision siç ju thashë, por të lepër të dëshiruar, puna në terren nuk ka punë, nuk ka punëtor që të vijë dhe të shikojë punonjës, kemi shumë në listë, por le të vijë vetë t'i shikojë edhe t'i kryetarë që kanë ardhur. Është për të ardhur keq, domethënë kjo pjesë nuk kemi. Nuk jam kundra që t'iu rritet rroga, por duam edhe punën se ne paguajmë taksa, paguajmë terra. Unë kam dy muaj që po ju them, kam marrë drejtorin e shërbimeve, kam marrë të gjithë dhe në një farë mënyre ne na prozvalin. Duke paguar taksa, duke paguar çdo gjë dhe shërbim ne nuk kemi fare dhe kjo është për të ardhur keq. Keq më vjen, po kjo është realiteti.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dakord, dakord. Unë shiko tani, territori, territori i bashkisë është shumë i madh. Edhe tashmë kemi arritur deri në atë pikë sa çdo gjë e kërkojmë t'ia bëjmë neve. Domethënë, që nga pastrimi i kanalit apo i derës së shtëpisë, të themi, që nga varrezat publike, nuk është për të ardhur keq, nuk po i heq asnjë presje asaj që ju citoni, por ka një neglizhencë, ka një mënyrë, çfarë të them unë, nga gjithë komuniteti, të cilët nuk përfshihen

në punë të cilat kanë të bëjnë me lagjen e tyre, me oborrin e tyre, me ku di unë, me shërbimet të ndryshme që janë, se nuk mund të arrihen 81 e fshatra, që të mund të mbulojnë me një punëtor apo dy punëtorë që ne mund të kemi në fshatra, të cilët ka fshatra që s'kemi punëtorë fare, apo i mbulojmë me një punëtor, mbulojmë tre-katër fshatra për shërbimin e vorrezave. Se në qoftë se do të kishim shkolla e punëtorë, vorreza e punëtorë, ku di unë, kanale e punëtorë, do të thosha që numri i tyre të ishte, nuk mund ta imagjinojmë dot sa mund të shkonte. Ndaj edhe shqetësimi juaj është me vend që do të duhet patjetër një kërkesë e madhe llogarie, por le të jetë ky një apel edhe për komunitetin, i cili duhet të jetë bashkëpunues edhe secili të bëjë një punë tek dera e shtëpisë, po themi, tek për të korrur barin aty. Jo çdo gjë pritet nga ne, por pritet çdo gjë që çdo gjë ta korrim barin ne, çdo cep të bashkisë, të jeni të bindur që s'kemi për të arritur dot kurrë. Ndaj edhe mirëkuptimi, bashkëpunimi edhe kontributi në komunitet do të ishte një. Por nuk i heq asnjë presje që nga ne, nga strukturat tona duhet kërkesë llogarie me madhe edhe nuk kam asnjë, asnjë ankesë që edhe ju si e si kështill të ngrini një grup pune dhe të verifikoni në terren dhe punën tonë konkrete edhe të sektorëve konkretë. Duke ardhur e duke parë edhe duke i vënë para përgjegjësisë se jemi për një qëllim të përbashkët, të dy organet, edhe këshilli edhe kryetari i bashkisë, që punët të jenë sa më efektive në territor.

Andonaq Risto: Kryetar, doja të thoja se unë nuk po them për pjesët e oborreve që njerëzit nuk po i pastrojnë, por janë objektet e bashkisë, janë shkolla, ish-shkolla, janë kopshtet, janë, ku është se unë po them për pjesë, unë po them për pjesë kolektive.

Faslli Zholi: Nildi, është ju, unë desha të shtoja këtu, shumë mirë u tha dhe nga këshilltari dhe nga kryetari i bashkisë, sepse që nga vetja ne jemi këshilltarë të zgjedhur dhe duhet të kërkojmë vetvetes njëherë në radhë të parë, se unë e filloj edhe që nga njerëzit, angazhimi i këshilltarëve që vijnë në mbledhjet apo në të gjitha gjërat, duhet edhe atje në komunitetin ku janë të zgjedhur edhe në të gjithë fshatrat duhet të bëhet një punë sa më shumë, të flasim me komunitetin se është e vërtetë ajo që tani edhe derën e shtëpisë nuk mund ta pastrojë as punonjësi, por jam në ata që tha dhe këshilltari që krejplejtë duhet të vihen në dispozicion të punëve të atyre punëtorëve që t'i shikojë, t'i reklamojë dhe t'i stimulojë dhe t'i kërkojë dhe llogari. Edhe qoftë edhe ekzekutivi, ata që ta justifikojnë ditën e punës, kushdo që është, se ne i flasim punëtorët, por dy punëtorë nuk mund ta mbulojnë tërë Libonikën. Kjo është e qartë. Po për këtë jam dakord se duhet secili nga neve, e them me bindje këtë, që duhet të kërkojmë edhe vetvetes edhe familjeve ku janë në rrugë. Se vërtetë kërkojnë atë, unë kam rrugën atje që do t'i them të ndryshmet dhe të mos jap përgjigje, që ka për ta bërë bashkia, që nuk e bëjnë dot ata. Po pastrimin duhet ta bëjnë edhe vetë qytetarët. Kjo do të jetë në, se ka qenë edhe traditë shumë e mirë, por ka humbur çdo gjë. Do të thoshte i kanë mbetur vetëm pleq, kanë mbetur, por secili ku ka mundësinë ta bëjë atë punë. Edhe jam plotësisht dakord që.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ka fshatra, ndihesin ndërpresë ka fshatra që dallojnë nga njëri-tjetri. Dhe kjo dallon jo për punën tonë të veçantë në atë fshat, por për punën e komunitetit. Midis tyre po marr edhe Tërovën, po marr fshatra të mëdha, Vashmia. Mund të shkosh në fshat, e ke të pastër dhe nuk gjen as plehë bagëtie, as plehra, asgjë. Pse është kështu? Jo se ne aty

bëjmë një punë ndryshe nga fshatrat e tjerë. Po komunitetet e këtyre fshatrave, ka edhe të tjerët, po mora vetëm një element, janë më kërkues edhe ndaj vetes tyre njëherë, sepse le komshiu komshinë, e ja kërkon që të pastrojë një copë kanali një njeri, të presë barin aty, të mbjellë dy lule dhe kështu mund të bëhet gjithçka. Patjetër ne duhet të marrim përsipër gjërat kolektive, pastaj gjërat e mëdha që s'mund t'i bëjë asnjë familje vetë.

Petrit Kupe: Nildi, duke patjetër duke miratuar këto ndryshime, do të sugjeroja që në lidhje me strukturën dhe menaxhimin e pagave, duket sikur çdo mbledhje këshilli bëjnë ndryshime. Për mendimin tim, kjo e bën një strukturë pak, jo të saktë, se struktura është si një kostum i qepur mirë në fund të dhjetorit, por gjatë vitit, me këto ndryshime, ky kostum anohet apo bëhet edhe i pakuptueshëm. Prandaj do të thosha që ndryshimet duhet të bëhen, por jo të shpeshta, jo kaq të shpeshta. Sepse struktura është bazë. Ato mund të grupohen në periudha, por mund të bëhen më të studiuara në momentin që hartojmë buxhetin në fillim të vitit, që këtë strukturë ta kemi solide dhe të edhe të monitorueshme. Këtë do të sugjeroja.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër? E kalojmë votimin atëherë. Pika 7.
Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka, me 17 vota pro miratohet pika 7 dhe kalojmë tek pika 8 e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e shpërblimit me honorar për angazhimin e një koreografi për ngritjen e ansamblit të valleve pranë valleve popullore, pranë Qendrës Kulturore Multifunksionale "Dimitri Orgocka" në Maliq. Komisioni i Kulturës.

Petrit Kupe: Patjetër, derisa do fillojë të funksionojë edhe Shtëpia e Kulturës, duhet një i tillë që të krijojë vazhdimësi ndaj valleve dhe të koreografisë për të rinjtë që do të trajnohen. Ne jemi dakord, është menduar që të miratohet.

Ornildi Demollari: Po?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne nuk kërkojmë shtesë fondesh, pasi fondi është parashikuar në buxhetin e strukturës së kulturës me një pozicion të përhershëm në koreograf, por duke qenë që nuk gjejmë koreograf që ta kemi me orë të përhershme dhe e marrim part-time, të themi, ndaj dhe po vjen ky ndryshim. Ndoshta ky projektvendim, Alma, mund të kërkojë edhe një ndryshim, ndryshim në fondet buxhetore për kalim nga 600, 601, 604, nuk e di si i keni strukturat buxhetore, për efekt që nga fondi i pagave të kalojë për honorare që ta keni pastaj. Dhe besoj që këshilli ta marrë bashkë me këtë ndryshim edhe të jetë më i plotë, besoj, ky projektvendim. Ndoshta nuk e di, a jam se kam merak, pastaj do sillen ndonjë projektvendim tjetër për ndryshim fondi. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Po, faleminderit. Kemi gjë tjetër? Kemi ndonjë pyetje? E kalojmë votimin duke marrë parasysh edhe korrigjimin e zjarrit buxhetor. Kush është dakord? 18 vota pro.Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka, miratohet me 18 vota pro. Dhe kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, pika 9, projektvendim për disa ndryshime në vendimin me numrin 146, datë

14/12, për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet dhe shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2026. Komisioni.

Pranvera Begolli: Të bëjë shpjegimet kryetari dhe pastaj Komisioni i Financës.

Ornildi Demollari: Kryetar. Po, lutem.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:anë disa rregullime në paketën fiskale të vitit 2026 që ka të bëjë për tarifat e ndryshme të blektorisë, tarifa minimale, edhe janë të mbështetura në ligj, të miratuara me ligj parlamenti, edhe për parqe voltaike, edhe pse ne s'kemi, por pse le të jenë pjesë e paketës fiskale, se në çdo rast mund të ndodhi. Tarifa të ndryshme për rrënjë, për dhitë, për kullotje, nuk besoj se ka ndonjë. Dhe e kemi bërë dhe një shtesë, të themi, për biznese të mëdha të cilat kanë NIPT sekondar. Të cilat ne deri dje i kemi tarifuar si biznese të reja apo si biznese unike, të themi, edhe po të vinin të kishin një NIPT sekondar. Tani i kemi bërë një ndryshim të tarifës së pastrimit, të ndriçimit dhe të gjelbërimit, që mos e rëndojmë që ajo të paguajë të njëjtën tarifë në dy vende, por ta paguajë diçka më të ulët. Ndaj dhe e kemi propozuar, po të shikoni pikën e dytë aty, për taksa mbi biznesin e madh. Për ato të cilat janë njësi rishitëse, të themi. Ai mund të ketë qendrën në Korçë dhe të ketë një NIPT sekondar në Maliq, të mos ketë të njëjtat gjëra ose edhe në vendet tjera. Këto ishin propozimet që ju kemi sjellë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Me këto ndryshime.Po, Komisioni, fal.

Petrit Kupe:Bëri mirë që e shpjegoi kryetari, por këtu nuk ka një relacion.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E keni dhe relacionin? Tani unë me materiali që ma ka dhënë Gerti, e kam me gjithë relacion. Tani në qoftë se mua ma ka dhënë ju, se ju ka dhënë ju.

Ornildi Demollari:Është në faqen mbrapa, është.

Petrit Kupe: Do ta bëni këtë pyetje, sepse unë e di që ka patur tarifa për këtë një pjesë, domethënë.

Drejtore e të Ardhurave në bashki;znj.Jona Grabocka: Lidhur me tarifat në sektorin e pyjeve e kullota, është një ripasqyrim i legjislacionit. Janë pasqyruar ndryshime të ligjit.Ndërsa për pjesën e dytë të projektvendimit, në qoftë se më lejoni, për pjesën e njësive rishitëse, bëhet fjalë për subjektet e mëdha të cilat në NIPT-in e tyre sekondar ushtrojnë tarifë të ndryshme nga ajo kryesore. Që do të thotë, në një, në selinë kryesore kanë aktivitet kryesor prodhim dhe në selinë e dytë, në aktivitetin e dytë kanë shitje. Domethënë, në qoftë se do të jetë dhe selia e dytë sërish prodhim, nuk përfitojnë nga kjo zbritje.

Andonaq Risto: Meqënëse jemi këtu tek taksat e biznesit të madh, unë jam ndër këto biznese të mëdha dhe e kemi diskutuar shumë herë këtë pjesë, që ne paguajmë taksa, por shërbim

s'marr.Unë aktualisht paguaj, meqënëse është dhe drejtoresha, e di shumë mirë, 520 mijë lekë në vit vetëm taksë pastrimi dhe unë nuk kam një kosh. Kam një vit që e kërkoj dhe është për të ardhur keq. Prandaj ju them që këtu është, s'dimë çfarë të themi. Drejtoresha është dhe vjen dhe në dijeni. Kemi bërë dhe mbledhjen në njësinë administrative, po. U bë një vit e gjysmë që ne taksat i paguajmë dhe shërbim s'marrim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani shërbimin, shërbimin e pastrimit ne e mbulojmë me sipërmarrje edhe i gjithë, gjithë mbulimi i sipërmarrjes bëhet sipas planifikimit që është bërë edhe ndarja e kosheve, të themi, apo sipërfaqet e pastruara, apo të korrura në çdo territor të bashkisë, sipas një limiti të përcaktuar që një kosh duhet të jetë, po them kot, në 10 familje, në 20 familje, në një lagje. Dhe kemi probleme në lagje që nuk pranojnë ta kenë koshin afër dhe fillojmë t'i spostojmë, t'i bëjmë. Ne nuk mund të çojmë kosh në çdo biznes, por që të ketë në afërsi të tyre patjetër dhe duhet të shikohet mundësia që në afërsi të edhe të biznesit. Duhet parë si rast, po e kam llafin, se në qoftë se ne kemi 800 biznese, duhet t'u çojmë 800 kosha. Tarifa e pastrimit nuk do të thotë që duhet të ketë secili biznes koshin e vet.

Andonaq Risto: Domethënë, nuk duhet të kemi shërbim vetëm...

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, jo, shërbim patjetër, patjetër. Tani unë nuk besoj se mbetjet që ju nxirrni nuk i merr dikush.Edhe për të, patjetër, edhe për të shpjeguar, edhe për të shpjeguar diçka, jo të gjitha bizneset, edhe bizneset e mëdha, bëjnë mbetje apo prodhojnë mbetje, njësoj të gjitha. Nuk mund të prodhojë njësoj mbetje një linjë e përpunimit metalik, të themi, me një supermarket. Por ideja është që ne, ne i kemi të standardizuara siç janë kudo, që çka biznese të mëdha e kanë vlerën 50 mijë lekë, me idenë që bizneset e mëdha kontribuojnë tek e përgjithshmja edhe për një pastrim më të mirë të fshatrave, të rrugëve, të qyteteve, të gjithë zonës, pasi e kanë edhe një çik mundësinë më shumë. Domethënë, ngarkesa e tyre shikohet dhe në këtë linjë. Po themi, po marr kot tarifën e ndriçimit, nuk është e thënë që ai paguan një tarifë ndriçimi në muaj apo në vit dhe duhet të ketë patjetër dritë në shtëpinë e tij. Jo, do ketë rruga kryesore, pastaj fillojnë rrugë dytësore, e për të thënë: "A ka mundësi t'i shkojmë deri në shtëpinë e tij? " Kjo do ishte më e mira. Dhe ne ndaj synojmë hap pas hapi ta përmirësojmë edhe ndriçimin rrugor, edhe pastrimin, dhe a kemi mundësi të vemi tek çdo biznes me një kosh më të vogël, të themi, me kosh i cili mund të jetë plastik, dhe ne jemi gati duke krijuar një projekt pilot për të bërë që të mos kemi kosha më fare. Do ta fillojmë nga qyteti i Maliqit, që t'i heqim koshat në zona të caktuara, që ata t'i mbajnë brenda banesave të tyre dhe a kanë mundësi që ato t'i ndajnë sipas llojit të mbetjeve dhe ne t'u ulim tarifat dhe të fillojmë të riciklojmë. Është një projekt pilot që mendojmë të realizohet shumë shpejt dhe Maliqi do të jetë nga të parët. Ne kemi zona edhe në Maliq, lagjet e sipërme nuk kanë kosha, por kanë një ditë të përcaktuar që makina vetë i merr mbetjet dhe janë zonat më të pastra që ne kemi. Ka forma të ndryshme, ndoshta kjo është një moment diskutimi që duhet, duhet të na angazhojë të gjithëve dhe këshillin dhe ne, për të bërë të mundur që të fillojmë të ndryshojmë edhe të ulim sasinë e mbetjeve që çojmë landfill dhe atje paguajmë për çdo ton mbetje që depozitojmë. Shqetësimi juaj, po jo vetëm i juaji, ka dhe biznese të tjera të cilat nga vendi që kanë, nga pozicioni që kanë, nga lartësia që kanë, duan

kosha dhe kanë të drejtë se paguajnë tarifë pastrimi dhe duan shërbim. Kjo duhet ndjekur hap pas hapi dhe patjetër duhet të vejë në shqetësimin e drejtorisë së shërbimeve, e cila e ndjek gjithë pastrimin e zonës dhe të qytetit. Unë të falenderoj për shqetësimin dhe patjetër do ta shikojmë edhe duhet zgjidhur sa më parë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, zoti kryetar. Kemi gjë tjetër këtu? E kalojmë votimin. Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet pika 9 e rendit të ditës. Dhe e kalojmë tek pika tjetër, pika 10, projektvendim për miratimin e raportit të parë të monitorimit të buxhetit për katërmujorin e parë të vitit aktual, të vitit 2026. Komisioni i Financës.
Petrit Kupe: Patjetër që jemi dakord për të miratuar këtë raport, sepse ai është një pakt që ne duhet ta kalojmë, por duhet të shohim brenda raportit, aty ku është dhe thelbi i Akilit në realizimin e të ardhurave. Plani katërmujor i këtij viti është më i ulët nga plani katërmujor i vitit të kaluar dhe realizimi është më i ulët nga realizimi i katërmujorit të kaluar. Pra, nuk është një tregues i kënaqshëm. Ajo që kemi, kemi folur edhe në mbledhjen e kaluar që ndikon, mendojmë, edhe që u miratua dhe nga Këshilli i Bashkisë, është kalimi i taksave pranë ujësjellsit. Në muajin e kaluar na thanë që nuk jemi, nuk erdhëm dakord për lidhjen e kontratës, por u bënë tre muaj që akoma s'është lidhur kontrata. Derisa e miratuam dhe ky, ky, ky kalim siguron të ardhura të mëdha, besoj se nuk duhet të lënë pas dore, sepse edhe të ardhurat kanë rënë. Është një nga rrugët që mendohet që të rriten të ardhurat, por duhesh realizuar. Tani pengesën nuk e dimë, mund ta shpjegojnë specialistët.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Një nga arsyet e edhe shifrave dhe e një rënie, të themi, të mosrealizimit të të ardhurave ka të bëjë edhe ky moment. E kalojmë, kur do e kalojmë, kemi bërë një ndalesë, kemi bërë përllogaritjet, listimet e tjera, por jemi në momentin që nuk po biem dakord, atë që e citoi edhe pak Petriti, me ujësjellësin në Korçë për efekt të tarifës që ata mbajnë si agjent tatimor. Ata deri në këtë moment mbajnë 2% për Bashkinë e Korçës edhe për Bashkinë e Devollit, të cilat e kryejnë këtë shërbim nëpërmjet ujësjellësit, se e kanë patur prej vitesh. Në momentin që flasim, ku aty ne kemi kërkuar të jemi bërë pjesë, t'i quaj, t'i kthejmë të jenë ata agjentët tanë tatimorë për efekt të vjeljes së taksave, Drejtoria, Agjencia Qendrore e Ujësjellës Kanalizimeve, e cila është dhe aksioneri kryesor, kërkon që kjo tarifë të rritet, të shtohet nga 2% deri në 3% dhe ne nuk po biem dakord tek 3%-shi. Nuk po bien më shumë dakord bashki të tjera siç është Bashkia e Korçës, e cila pagesa është më e madhe se e jona. Patjetër se edhe sasia e vjeljeve është më e madhe dhe jemi në diskutim e sipër, ndoshta për të gjetur një të mesme, as tre, as dy, po tek 2. 5%. Të shpresojmë që do të biem dakord shpejt dhe ne t'ja u sjellim si propozim edhe të lidhim aktmarrëveshjen për të vazhduar punën.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër? Tek raporti, drejtoreshë, i thamë të gjitha. E kalojmë votimin atëherë. Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka. Miratohet pika 10, raporti i katërmujorit të parë të monitorimit. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës. Pika 11, projektvendim për miratimin e programit të transparencës të Bashkisë së Maliqit.

Pranvera Begolli: Përshëndetje. Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike u mbyll sot dhe aktualisht është për të miratuar një program model të transparencës për njësitë e veçqeverisjes vendore, por është një procedurë që bëhet çdo vit, por këtë radhë për herë të parë ka një ndryshim, sepse në këtë program përfshihen dhe informacione për këshillat bashkiake. Pra, çfarë procedurash ka këshilli bashkiak? Informacione që bën bëhet publiku për kërkesë, informacion rreth komisioneve, për kushtet rregullore të këshillit dhe njësive e veçqeverisjes vendore, për veprimtarinë e këshillit dhe komunikim me publikun dhe aspekte të tjera, si dhe për dëgjesat që bëhen. Dhe mendoj që ky program është një program model që duhet të miratohet. Mendoj që do marrë dhe mbështetjen e të gjithë kolegëve këshilltarë. Në qoftë se kryetari mund të shtojë diçka më shumë rreth kësaj, ju falenderoj për mirëkuptimin.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mund të them diçka. Ky është një projekt që Bashkia e vazhdon ta realizojë me mbështetjen e bashkive të forta, por besoj që brenda materialit ka dhe disa gjëra që duhen trajtuar. Unë e kam bërë vërejtje në kuptimin e grupit që ka punuar me këtë punë. Po marr disa, po them, numrin total të punonjësve që punojnë në administratën e bashkisë. Po ta shikoni në material, është 602. Në fakt, nuk është 602, por është 159. Dhe sa janë femra? Nuk janë 105, por janë ca lapsuse të cilat varet në kë këndvështrim e kanë parë. Nga ana tjetër, punonjës mbështetës në shkolla.

Ornildi Demollari: Kryetar, më fal, është tjetër kjo. Është për programin e transparencës që bëjmë. Është pak më, është pak më mbrapa kjo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ndjesë.

Ornildi Demollari:Është pak më mbrapa kjo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Thash se kishit raportin e performancës. Ndjesë, ndjesë.

Ornildi Demollari: Është pak më mbrapa. Është në kuadër të transparencës. Po në këtë, në këtë, në këtë vit është shtuar edhe një fokus, një fokus tek transparenca e anëtarëve të këshillit bashkiak për të bërë një prezantim të shkurtër.

Ornildi Demollari: Nuk ka asgjë për atë. Jam okej, jemi në rregull. Kemi gjë tjetër atëherë te kjo nga kolegët, të paktën? E kalojmë votimin. Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka. Miratohet me 18 vota pro. Dhe kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që është pika 12 dhe konkretisht projektvendim për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve nga programi i subvencionimit të qirasë. Komisioni Idlir.

Ildli Limllari: Janë katër veta në kjo listë, tre kryefamiljare dhe një kryefamiljar. S'ka ndonjë, do është miratuar lista përfundimtare e përfitimit të qirasë nga buxheti i shtetit, nga të ardhurat që ka bashkia nga buxheti i shtetit. Ne jemi dakord.

Ornildi Demollari: Faleminderit.

Faslli Zholi:Është miratuar herën e parë paraprakisht. Tani kanë ardhur fondet, kështu që mendojmë që ta kalojmë për votim.

Ornildi Demollari: Kemi gjë ndonjë pyetje këtu? E kalojmë votimin atëherë. Kush është dakord? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka. Me 18 vota miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës. Pika 13, projektvendim për miratimin në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor për ndërtimin e kullave eolike nga kompania WP Morava Shpk, për të cilën është realizuar edhe një dëgjesë me banorët para disa ditësh, ku në fakt nuk keni marrë pjesë, të paktën edhe këshilltarët e zonës. Dhe banorët janë shprehur dakord parimisht. Kishin vetëm disa sugjerime të vogla dhe konkretisht ishte në ndonjë shërbim apo investim që kompania mund të bëjë për komunitetin atje, për një infrastrukturë apo në objekte publike, shkolla e të tjera. Gjithashtu kishin kërkesë për mundësinë e punësimit të banorëve vendas, nëse kompania do të do të nisë punën. Kishin dhe një merak tjetër për punën e shpërthimeve, që projekti të realizohet, po të mos ketë shpërthime. Mbase duke parë që kompania ishte përfaqësuesi i Favinës, një kompani e cila merret me prodhimin e inerteve, kërkuan që të paktën të mos ketë shpërthime gjatë zbatimit të projektit. Pastaj në finale ishin dakord. Ka ndonjë pyetje?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të shpjegoj diçka? Tani, kjo është një, unë e quaj një gjë pozitive. Është një projekt, nuk është projekt vetëm i bashkisë tonë, por është një projekt rajonal për Bashkinë e Devollit, Bashkinë e Korçës. Dy bashki të tjera e kanë dhënë miratimin në parim. Nuk është vendosur se edhe aty do të bëhen prova ka herë, s'ka herë, ja vlen, s'ja vlen. Janë projekte të mëdha që miratohen rrang qeverie. Ne në parim japim një dakordësi dhe shumë mirë që është bërë dhe dëgjesa publike dhe është një gjë pozitive që banorët të njihen. Nuk ka dëmtime të tokës, të pasurisë, të tjera, pasi vetëm një kullë mund të jenë, dy-tre kulla, se kam idenë saktësisht. Dy kulla janë. Kështu që kjo është pozitive për efekt patjetër se në qoftë se do të ketë nevojë për punëtorë, pra aty do merren, nuk do merren në vend tjetër. Qëllimi edhe ajo që duhet të vlerësojmë në këtë pjesë është që investohet, nuk dëmtohet mjedisi edhe i shërben gjithë komunitetit apo për atë të cilin ata. Komuniteti ka rënë dakord, nuk ka ndonjë, kështu që unë në parim do të shprehesha dakord dhe do të kërkoja mirëkuptimin e këshillit për këtë pjesë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kryetar. Kemi diçka tjetër?

Petrit Kupe: Meqënëse është pjesë e komisionit më në fund, po ju në lidhje shpjeguat, nuk na la të bëjmë shumë.

Ornildi Demollari: Po, duke qenë se isha në dëgjesë, prandaj e kisha dhe si.

Petrit Kupe: Patjetër që e mbështetim, sepse ashtu siç tha edhe kryetari, është një investim që do ndikojë. Aq sa do ndikojë, se nuk besoj se në punësim do ndikojë sa aty.

Ornildi Demollari: Vetëm në ndërtim mund të ketë diçka.

Petrit Kupe: Se ato komandohen me pult. Megjithatë, është një gjë e mirë që aty s'ka probleme as së prishje të ambientit e tjera, kështu që këto iniciativa do të mbështetura. Nuk kemi pse të tregohemi konservatorë ose të ngushtë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. E kalojmë votimin atëherë. Kush është dakord? Në parim? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet. Pika 13, miratohet me 18 vota pro. Faleminderit. Kalojmë tek pika tjetër. Pika 14, projektvendim për një vendim, një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak me numër 19, datë 31. 01. 2026, për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq. Dhe është fjala për një sipërfaqe në zonën e Moglicës, ku këshilli ka, ka marrë një vendim për të dhënë një sipërfaqe në përdorim, por atij projekti i duhet edhe diçka më tepër, një sipërfaqe më tepër, apo jo? Prandaj e ka.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nga 20 metra në 100 metra, nuk është ndonjë. Për të ngritur antenën, u shërben komunitetit, kështu që besoj.

Ornildi Demollari: Po, komuniteti edhe aty është bërë dëgjesë dhe komuniteti e ka shumë të nevojshme, pasi nuk mbulohet me valë telefonike. Është bërë dëgjesa për. Dëgjesën për 20 metra e bëmë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ata e kanë kërkuar vetë, domethënë banorët e duan, se s'është se e kanë bërë për 20, çfarë ndryshon tek 100-ta, domethënë.

Petrit Kupe: Vetëm nuk na tregohet sa, sa mund të përfitojmë nga kjo qira, domethënë. Këta pyjorët e kanë të vështirë sa llogariten.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po ajo është, ajo është në bazë të tarifave të. Nuk ta them dot tani se nuk.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje/Kullota;z.Klarsen Brako: Po zakonisht antenat maksimumi 250 mijë lekë në vit mund të mbajnë në rastin e rastit.

Ornildi Demollari: Dakord. E kalojmë votimin atëherë. Kush është dakord? 18 vota pro.Kundër? Nuk ka, abstenim nuk ka. Me 18 vota pro miratohet. Dhe kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës. Projektvendim për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Pallati i Kulturës Dimitri Orgocka" në Maliq. Komisioni e ka, e ka diskutuar këtë. Kryetar, mund të na shpjegosh diçka për këtë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, kemi një problem në zbatim të projektit. Nuk është se projekti në vetvete do ketë ndërtim në atë pjesë, prapë do jetë pjesë e lulishtes. Ajo lulishte ka

qenë, pavarësisht që ju është kthyer pronarëve me, me vendim gjykate, me vendim të komisionit të kthimit të pronave, nuk është rreth një sipërfaqe rreth 500 metra katrore. Vetë pjesa e ndërtimeve që është aty, Pallati i Kulturës me dy kate, me tre, të themi tani, bashkë me çatinë, shkolla e mesme në anën tjetër me gjithë rrethimin që është pronë publike, sipërfaqja prej 500 metra katrore nuk mund të ndërtohet aty as nga privati. Dhe në kushtet kur ajo nuk ndërtohet, nga ne nuk përdoret se është pronë private, atëherë ne kërkojmë, i kërkojmë këshillit, po i kemi kërkuar edhe pronarëve, të themi, dhe ata kanë rënë dakord që ne të kalojmë në proces shpronësimi për interes publik dhe ta kthejmë përsëri në lulishte siç ka qenë. Dhe ideja është që ajo ngelet një hapësirë e gjelbër në shërbim të qytetit, të trajtohet, patjetër do trajtohet më mirë kur të marrë zhvillim dhe zona e shkollës së mesme me ndërtim palestrash, me një projekt që ne tashmë e kemi realizuar dhe kemi, kemi kërkuar financim. Dhe ndërtimin në atë zonë, si nga privati, si nga ne, do ta dëmtonte pamjen e asaj zone. Në kushtet që jemi, që ne jemi duke zbatuar një projekt për lulishte, për një lulishte me vaditje qendrore, etj., etj., unë propozimi që kemi sjellë të këshillit është ndoshta duhet ta kishim bërë dhe më parë, por le të, le të vrapojmë, të shpejtojmë që ta bëjmë sa më parë dhe ajo të marrë një pamje të bukur siç po merr gjithë zona aty e Qendrës Komunitare e Pallatit të Kulturës. Patjetër, drejtoria e pronave po bën gjithë dokumentacionin, se ndoshta mund të keni ndonjë vrejtje për mungesë dokumentacioni, një numër pasurie, jo, një plan vendosje etj. Projekti është i plotësuar edhe me projektin tonë të zbatimit që po bëjmë për lulishten. Në qoftë se këshilli e kërkon një informacion shtesë, ne mund t'ia vëmë në dispozicion në mbledhjen e radhës.

Ornildi Demollari: Faleminderit.

Faslli Zholi: Unë do të isha shumë dakord, sepse e di atij pozicioni si është dhe shkolla dhe jam në institucione publike dhe do të sforcaremi pak, po do të ngelet e shtetit, kur them e komunitetit, për të mirë. Se të njëjtën gjë duhet të kishim bërë edhe atij që ia dhamë Festimit mes Libonikut, edhe ajo është bërë gabimi që iku ajo punë, kështu që kjo ia vlen që të bëhet dhe të shpronësohet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë nuk dua të shpjegoj një ditë, po mbetet tre ditë. Dua të shpjegoj dhe një moment për pronarët, që edhe pronarët janë të interesuar dhe u bëhet mirë kjo pjesë, pasi ata me ato largësi, me ato kondicione që ka zona, nuk mund të ndërtojnë dot. Dhe duke qenë se ngelet diçka e vdekur, kështu që më mirë i kompensojmë ne dhe ata përfitojnë vlerën monetare sipas akteve ligjore në fuqi dhe qytetit i ngelet një lulishte e trajtuar. Të njëjtën gjë e kemi para bashkisë, por rast pas rasti të shikojmë që ne kemi zonat që i kanë pronarët dhe ngelen, po t'i shikosh si mall pa zot, të themi, të patrajtuara, të paurbanizuara.

Ornildi Demollari: Faleminderit. E kalojmë votimin. Kush është dakord?18 vota pro
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Me 18 vota pro miratohet. Faleminderit. Dhe tani jemi tek prezantimi i raportit të performancës, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë e tregova pak, ndoshta pas saj komisioni po të ketë mundësi të shtojë ndonjë gjë, por nga ajo që unë jam njohur me materialin, ka disa, disa gjëra që

duhen, duhen trajtuar dhe duhen përmirësuar, por ka dhe disa gjëra që dua t'i shpjegoj. Punonjësit e mbështetjes në shkolla, ne nuk e kemi me ulje, po jemi në të njëjtat nivele, mos të them që mund të kemi bërë një përmirësim në atë. Në lidhje me godinat e shkalla e regjistrimit të vajzave në çerdhe, ne në fakt s'kemi çerdhe, pavarësisht se programi e ka të tillë dhe hedhin edhe aty shifra, po shikoj ca shifra 17, 99, edhe pse në përqindje është zero, zero. Unë them që programi apo ky raport performance duhet të jetë sa më i saktë, jo vetëm për ne, por edhe për komunitetin, i cili hyn në faqen e bashkisë dhe kupton ç'ndodh. A duhet të shikojmë neve që kemi mundësi që të mendojmë shumë shpejt që të kemi një çerdhe? Hajde ta mendojmë. Dhe kjo është në atë çfarë ne duhet ta trajtojmë, që të shikojmë ku kemi godina, që të kemi një çerdhe publike që mund të shërbejë të gjithë nenave të reja, të cilat sjellin kalamajtë me, me ushqim apo pa ushqim. Kjo është për t'u diskutuar, që ato të kenë mundësi edhe të punojnë, se nuk kanë të gjitha vjera të mira. Apo nuk kanë të gjitha vjera, se vjerat gjitha të mira janë, po mos hap një debat për këtë pjesë. Disa momente të tjera ka të bëjë me mbetjet e gjeneruara kilogram banor, që ka mësuar ulje, dhe kjo është pozitive, se kur bie mbetjet do të thotë që ka një përmirësim në menaxhimin, apo një nuk i hedhin tërë mbetjet për t'i çuar në lëndëfilli. Mbulimi i kostove ka mësuar një rritje sipas. Në fakt, ne tarifa e mbetjeve në aty ku e çojmë neve ka mësuar ulje tek e përgjithshmja, dhe ndoshta në vlera absolute duhet parë me sektorin përkatës që a jemi të saktë në shifra apo jo. Është një material shumë i gjerë. Jo çdo gjë kapet nga të gjithë, edhe nga muaji i pari, por nga njohja që i njoh gjithë problematikën e bashkisë apo zërat kryesor, disa piketa unë i ngre sikur t'i ngremë bashkërisht si dy institucione për të parë që ka apo jo. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike. Në material thuhet që ka rritje. Në fakt nuk ka rritje, janë ulur numri i familjeve. Dhe nuk e di pse del kështu. Drejtoria, bashkë me sektorin e performancës, duhet ta trajtojë. Më thanë që kanë futur edhe disa zëra të tjera, por në fakt zërat s'mund ta. .. Se ai që lexon, ju mund ta kini në kokën tuaj si të ka mësuar ky ndryshim, por unë që lexoj them: "Ajo që janë rritur? " Jo. Në fakt nuk janë rritur, janë ulur. Si punë e këtyre zërave mund të ketë dhe zëra të tjera, ndaj dhe unë mendoj, kryetar, mendoj të nderuar këshilltarë, që ekzekutivi, para se edhe pse tani ta kalojmë, nuk e di merr ndonjë miratim apo jo, prezantim të bëjë ato reallikime, reallikimet e duhura që të jetë sa më i saktë në shifra, në vlerë dhe në piketa të cilat janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për ne, por edhe atje ku prezantohemi, se ky raport performance do të shkojë në ministri, do të shkojë tek institucionet të cilat, në bazë të performancës, edhe të vlerësojnë, edhe të mbështesin, etj. Shumë faleminderit, kaq kisha.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Ka ndonjë pyetje për raportin e performancës? Jo, nuk ka. Faleminderit. Tani këto ishin pikat, tani jemi tek diskutime të tjera. Së pari dua të t'ju njoh me një kërkesë që i është paraqitur këshillit dhe përpara se t'ju lexoj kërkesën, dua t'ju njoftoj që në mbarim të mbledhjes së këshillit do të zhvillohet mbledhja e asamblesë së zgjeruar të Kombinat Sheqerit, kështu që do t'ju lutesha të mos largoheni. Atëherë, kërkesë drejtuar këshillit bashkiak: Unë i nënshkruari me iniciale XH.J, banuesi i fshatit Rrëmbec, njësi administrative Pojan, jetoj në kushte shumë të vështira, shumë të vështira, pasi banesa ime është tejet e amortizuar. Në banesë jetoj me nenën time dhe me gjyshen time, pasi babai më ka ndërruar jetë. Me anën e kësaj kërkese, i drejtohem këshillit bashkiak Maliq që të më japë leje për të rindërtuar shtëpinë time, pasi nga çasti në çast mund të bjerë tavani dhe kam dy pleq në shtëpi të cilët rrezikohen për jetën.

Kushtet e mia financiare nuk më premtojnë për të ndërtuar shtëpinë time, pasi nuk kam të ardhura të mjaftueshme dhe investitorë janë disa shokë dhe miqtë e mi që do të kontribuojnë dhe do të më ndihmojnë për të ndërtuar shtëpinë. Pengesë më është bërë leja e ndërtimit dhe për këtë arsye ju drejtohem ju si organ kompetent. Dua që kërkesa ime të merret parasysh. Ju faleminderit për mirëkuptimin. Domethënë, kërkon leje, vetëm leje nga ne, sepse do t'ia ndërtojnë disa miq.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shumë dakord, po këshilli nuk e ka kompetencë të japë leje ndërtimi. Jo, jo, të shpjegoj që unë nuk e di rastin konkret. Ndoshta nuk e di a e di zyra e strehimit apo. .. Ne kemi të drejtë t'i japim një autorizim për riparim çatie, riparim mure, çfarë ka, që janë kosto minimale. Në qoftë se ai personi në fjalë edhe ka shtëpi, edhe është jashtë në hall, edhe po e ndihmojnë shokët dhe pastaj do të bëjë shtëpi nga themelet me kolona e me të tjera, kjo nuk ndodh. Në qoftë se do të bëjë me autorizim riparim të mureve dhe riparim dhe ndërtim të çatisë, bëhet me një autorizim kundrejt një pagese 3. 000 lekë apo 5. 000 lekë, e cila për mua nuk mendoj që është ndonjë kosto e madhe. Kështu që le të rakoridohet ky moment dhe për mua është e zgjidhur në një farë mënyre. Shumë, unë do e falenderoja shumë mirë ata që duan ta ndihmojnë, edhe a kemi raste të këtilla që të ndihmojmë sa më shumë familje?

Andonaq Risto: Kryetar, ne vajtëm në vend dhe duke qenë si merremi me këtë punë dhe pothuajse jemi specialistë të asaj pune. Aty themele nuk kanë, banesat janë shumë të vjetra dhe si pasojë muret janë zhvendosur dhe kjo do një rregullim, si po të them, të themeleve. Kështu që nuk mund të bësh një mur pa rregulluar themelet dhe ka disa vende që ajo duhet të prishur e gjitha deri në fund dhe të rindërtohet. Se ne e kemi parë në terren.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë ligjërisht mund të them vetëm këtë, që ne japim leje për riparim muresh, që është kjo që thua e ti, për ndërtim çatie dhe riparimi i mureve dhe ndërtimi i çatisë rregullohet një shtëpi. Unë kaq di të them për mua, nuk mund të them gjë më shumë se kaq, se pastaj e shkelur rregullin.

Andonaq Risto:Kështu do të bëhet ajo, kryetar. Kështu do të bëhet, do të riparohen ato pjesë që janë të dëmtuara dhe do të...

Idlir Limllari: Atë, atë Nildi, më fal.Atë deklaratën apo këtë që tha kryetari, autorizimin ta marrë pa pagesë, mendoj unë. .

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ne nuk mund ta marrim pa pagesë. Ne mund t'i japim 3. 000 lekë apo 5. 000 lekë në ndihmë të kësaj familjeje dhe ai të mbetet të marrë autorizimin, se s'mund t'i japim ne, se do hapim pastaj... Ne mund të hapim pastaj për të gjithë të tjerët. Por nuk është problem kjo, nuk besoj se është problem kjo.

Faslli Zholi: Jemi tek të ndryshmet, po. Është te ne të ndryshmet. Dua ta filloj njëherë. Ajo nena atje, kryetar, ka ardhur disa herë. Ne kemi bërë një vendim të këshillit si e ka problemin edhe ne kemi bërë një vendim. Ajo thotë: "Kam biseduar, do ta zgjidhim." Kush e ka se më vjen keq për

moshën një që... Ta kalojmë atë pyetje të parë. E para, ja një minutë, nena. E para, nena, një minutë. Kemi punë aty ne, prandaj. E dyta që desha të shtroj njëherë. Nga disa ankesa që kam nga qytetarët, dua të falenderoj njëherë juve dhe bashkinë që për shtrimin e rrugës që bëri në Moglicë-Zerec përpjetë. E kemi parë nëpërmjet Facebook-ut. Do të vejmë ta shikojmë edhe mundësisht, po të...Edhe kështu po më thonë, po do vejmë të... Edhe ftoj dhe kushdo i kështilltarë se është edhe festa datën 6 qershor në Teqeja e Vrepskës. Janë dy festa, është edhe ajo e Qafës së Gjarprit, po atë se përmend njeri, po është festa kështu. Edhe të them edhe ty si kryetar, po deshe të vejmë atë ditë edhe ta shikojmë ca gjëra dhe do bëhet mirë. Edhe ta shikojmë dhe ta. .. Dhe një dy probleme që kam në lidhje me ndriçimet. E kam ngritur sa herë. Më thonë në Vloçisht, ka vajtur dhe Eri, fola dhe sot, ka parë aty për dy drita atje, bëhet problem, marrin njerëzit të shikohet si ashtu. Dhe aty në rruga në Libonik kemi lënë bashkërisht një llaf që të bëjmë atë kanalin që është i hapur, tash është i nxehtë për të futur tubat. Plus asaj është çarë puseta dhe e ulët e zeza që kalojnë edhe të fermës, ato janë të hapura. Është çarë puseta, mund të bjerë ndonjë njeri e makina e të tjera. Dhe komunikova ditën e radhën e parë me këta të policisë bashkiake, se ishin ca makina të mbetura rrugës dhe një makinë si këtu ka dhe plot të tjera. Duhet t'i krejë policia bashkiake ato makina që nuk ndizen, t'i heqin nga rrugët, sepse pengojnë makinën e plehrave, pengojnë shumë gjëra. Dhe një diçka aty tek familja Kanani u është thënë për të hedhur atë që e kemi parë edhe së bashku, për të hedhur pak zhavorr aty. Nuk është ndonjë madh e madhe që t'i ngrihet pak pjesa atje, që mos të hyjnë ujërat brenda. E kemi parë aktualisht. Këto desha të të thoshja. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Ato dy zonjat... Jo, Vasilika, ajo zonja mbrapa.

Qyetari: Kjo ishte rruga. Unë kam atë problemin e asaj tapisë të atij që është i parti. Makina ka ecur vetëm një aty atre dhe kërkon rrugë atje. Unë atë rrugë të kom shijuar. Nuk kam. Se ata të tjerët që kanë ardhur nga kjo vend këtu, i ka hedhur këtu. Po rrugë nuk ka. Edhe ata që e kanë rrugën, kanë dalë këtu, njëherë këtu, njëherë këtu, njëherë këtu. Rrugë nuk kanë lënë. Nxirren vëlla me vëlla. Këtë e dinë ata. Ne s'kemi rrugë. Se unë e kam. Metruar. Stacioni ka të drejtuar me Petrikun. Stacioni tha: "Ec ato, mikin mua tha në 100 miligramë shtjellë tha edhe do vij rrugën. " Ajo thotë: "Kam me pres sherr. " Po sa rande po me pres sherr? Thotë: "Ke gjak. " Një djalë e kam sëmurë. A më vjen gjak apo s'më vjen? E kam në Greqi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Cili, cili ja është shqetësimi jot? Makinat u hoqën mjetet atje? Tani kërkon rrugë.

Qyetari:E rrugë patjetër. Unë s'kam lekë atëherë me nxjerrë me çështje të tilla.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:A ka rrugë? Aty, aty, aty ka ardhur komisioni dhe duhet përcaktuar a ka rrugë. Po s'ka rrugë, ne nuk bëjmë dot rrugë. Ti do rrugë apo s'do rrugë?

Qyetari: Po nuk u ka rrugë atje. Nuk ka. A je që s'ka rrugë? S'ka rrugë. Edhe kanalizimet kurrë çanën. Vetëm unë nuk desha të vij në lagje se thashë do vij në shtëpi. Edhe ajo lagjja është pa

kanalizim. Këtë unë nuk e thashë. Po të doni të më ndihmoni, do bëhet me gjak se do lehtësojmë një trup. Dhe bashkia tha më mbaro si. Se një e kam sëmurë, po ta sjell unë. Po të shihni. Nuk ka kështu, kaq. Për kryetarin jam shumë e kënaqur se i tha: "Hiqi dhe i ka ecur. " Çfarë i ka ecur? Kur dua unë do të vij. Thotë: "Hajde. " Po e çkoj dashja atje. Edhe ata po më shijojnë kanalet. Unë nuk e di. Se ato që kam shitur unë atje, e kam lënë vendin e rrugës së ai. Kam lënë unë 3 metra, ka lënë edhe ai 3 metra që të dalë dikush dhe e humbur. Kurse ata të tjerët nuk kanë rrugë. E kanë të poshtëm të zakonshëm.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, o Xhie, kur lihet rruga, rruga nuk është e njerëzve apo rruga është e të terrëve.

Qyetari:E di ta bëj krejt ti, po tokën që kam shitur e caktoj unë e di unë. Edhe kur e kem shitur tokën, edhe ladhi që ka zënë ka lënë 3 metra. Edhe ky tjetri që e blen e la 3 metra.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po si, si e la 3 metra? Ajo po e ka tokën, e ka të tijën, e bën si të dojë. Nuk e di. Dua ta shikoj se ndoshta ky, ky lloj diskutimi nuk është për këshillin. Nuk ka çfarë të bëjë këshilli për këtë pjesë.O xhie, më dëgjo, më dëgjo një moment. Rruga nuk ka të bëjë me kartat tende. Ne i kemi hartat e fshatrave dhe në një rrugë, në një fshat. Po ka rrugë, ka rrugë. Po s'ka rrugë, s'ka rrugë.Po s'ka, s'ka. Cili është shqetësimi jot tani?Ta diskutojmë me vete se unë nuk po të kuptoj. Ti do rrugë apo s'do rrugë? Ta shikojmë atëherë. Ta shikojmë dokumentat. Çfarë të them unë?

Ornildi Demollari: Po.Keni bërë një kërkesë për taksat, po?

Qyetari: Edhe më dy muaj u shkoi Tirana. Ajo shkoi Tiranë, por ça bëri ajo? Se sa i pagua. E zgjodhi. Javë e dera ishte shumë mirë. Deri. Kam të afërm. Kam burrën, e kemi. Dy muaj ne shkojmë në Tiranë. Nuk e njeh Korçën atë. Operuar dy herë Tiranë, bëj pas. Plus asaj ka tension dhe ia bëjmë. Më kupton? Dhe unë nuk e përballoj dot tashi. Jo se janë aq kalova, as s'ka gjë taksa. Ka qenë me sinqeritet.Tani dola. Tani dola. Ka dy-tre muaj. Gjithashtu dhe kryetari. Kryetari ka bërë një kërkesë. E kam takuar një mëngjes. Nga kjo. Por jo se unë në bashki tre herë kam shkelur kësaj bashkie dhe nuk më merr fare asgjë. Nuk dua asgjë. Vetëm këtë.

Ornildi Demollari:E kuptuam. Të shkuara burrit.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti:Përshëndetje. Familja ka bërë një kërkesë para dy ditësh. Ne do bëjmë verifikime dhe do ta paraqesim në këshill në qoftë se është e nevojshme.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Në qoftë se ne e shtojmë vendimmarrjen që morëm sot dhe ju plotësoni dokumentacionin, se ndoshta rasti nuk prek, besoj se.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti: Po, rasti është problematik faktikisht. Rasti është problematik. Ka nevojë tani në qoftë se ju e shikoni të arsyeshme. Me kuptimin e këshillit.

Faslli Zholi:Ëh, po. Po, është rasti siç po e dëgjojmë problematik. Të ndihmohet zonja. Dhe në qoftë se është e mundur, në qoftë se është e mundur, futeni që sot të mos e.

Ornildi Demollari: Biem dakord ta shtojmë tek ato familjet në nevojë. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Dakord. Mirë. Kur të zbardhet vendimi, Ermanda.

Pranvera Begolli: Meqënëse jemi të të ndryshmet, e di që kryetari do bezdiset një çik, po. Unë e falenderoj për investimet që ka bërë qyteti, për ajo lagjeri që ka ndaj lartë. Do ca problematika. Dhe e ke premtuar për një asfaltim të asaj rrugës mbrapa.

Ornildi Demollari: Po, Do desha t'ju bëja thirrje grupit të maxhorancës të sillni propozimin për anëtarin e këshillit të Qarkut, pasi kemi një vend vakant dhe ka qenë një vajzë dhe duhet të zëvendësohet me një vajzë. Besoj të paktën sipas kritereve. Po ka ngelur mbrapa kjo pjesë. Ndoshta mbledhjen e radhës. Mirë, kjo ishte mbledhja e këshillit. Faleminderit.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ